



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK

RELACION

PËR NJË NDRYSHIM TË VKB NR. 183 DATË 28.12.2022 “MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2023 DHE PBA 2023-2025 TË BASHKISË KORÇË, I NDRYSHUAR

Në zbatim të ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, neni 9, pika c, ku përcaktohet shpërblimi mujor i këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, si dhe VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, sipas të cilës për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100,001-200,000 banorë, kufiri maksimal në lekë në muaj bëhet 170,000 lekë. Për këtë arsye, duke u bazuar sa më sipër shpërblimi mujor i këshilltarëve është 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë dhe konkretisht 17,000 lekë/muaj.

Gjithashtu shpërblimi mujor për kryetarët e fshatrave do të jetë 10% e pagës së administratorit të Njësive Administrative.

Efektet financiare të rritjes të shpenzimeve për shpërblimin e këshilltarëve në vlerën 656,000 lekë do të përballohen nga shpenzimet operative të Bashkisë, të cilat do të detajohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Efektet financiare të rritjes të shpenzimeve për shpërblimin e kryetarëve të fshatrave në vlerën 240,000 lekë do të përballohen nga shpenzimet operative të Bashkisë, të cilat do të detajohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Masa e shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave fillon nga 1.4.2023.

Duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të pagës minimale

në shkallë vendi”, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV” si dhe VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, kërkojmë të miratohet masa e shpërblimit mujor i këshilltarëve në vlerën 17,000 lekë, 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë dhe masa e shpërblimit mujor për kryetarët e fshatrave 10% e pagës së administratorit të Njësive Administrative.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS
BUXHETIT MENAXHIMIT
FINANCIAR DHE KONTROLLIT
Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE MENAXHIMIT
TË BURIMEVE NJERËZORE
Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI

KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ date _____ . _____ .2023

PËR NJË NDRYSHIM TË VKB NR. 183 DATË 28.12.2022 “MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2023 DHE PBA 2023-2025 TË BASHKISË KORÇË, I NDRYSHUAR

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjin nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë masën e shpërblimit mujor të këshilltarëve në vlerën 17,000 lekë, 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
2. Të miratojë masën e shpërblimit mujor për kryetarët e fshatrave do të jetë 10% e pagës së administratorit të Njësive Administrative.
3. Efektet financiare do të përballohen nga shpenzimet operative të Bashkisë dhe do të detajohen me urdhër të Kryetarit dhe fillojnë nga 1.4.2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike .

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

Ana VERUSHI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____